



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002831/5

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandim për respektimin e rregullave dhe të të drejtave të shtetasve gjatë shoqërimit të tyre në ambientet e organeve të Policisë së Shtetit apo në institucione të tjera në përputhje me aktet normative në fuqi.*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë**

**DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Tiranë**

**KOMISARIATIT TË POLICISË NR. 6
Tiranë**

Sikurse ju kemi vënë në dijeni me shkresën nr. K2/I60-2 prot., datë 24.09.2020, Institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar me nismën e vet rastin e bërë publik në media nga gjyqtarja M. M. në datën 12.09.2020. Shtetësja në fjalë ngriti para mediave disa pretendime ndaj strukturave të Policisë së Shtetit për shkeljen e procedurës standarde dhe të rregullave që normojnë veprimtarinë e këtij organi lidhur me shoqërimin e shtetasve në organet e drejtësisë. Sipas saj, punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë i kanë shkuar në banesë dhe i kanë kërkuar ta shoqëronin atë në gjykatë. Ajo u ka kërkuar atyre urdhrin e shoqërimit të saj të nxjerrë nga gjykata për këtë veprim që do të kryhej nga punonjësit e policisë, por ata nuk e kanë patur atë me vete dhe për rrjedhojë nuk i kanë dhënë një kopje znj. Margjeka. Sipas saj, dokumentacioni në rastin e saj është hartuar në kundërshtim me aktet normative në fuqi, pas kryerjes së veprimit të shoqërimit.

Ndërkohë ajo është shprehur se gjatë shoqërimit të saj për në gjykatë në përbërjen e grupit të shoqërimit nuk kishte një punonjëse të policisë femër, e të njëjtës gjini me personin e shoqëruar, sikurse parashikohet në aktet normative përkatëse.

Gjithashtu ajo ngriti edhe shqetësimin se punonjësit e policisë që e kanë shoqëruar nuk ishin të qartë se ku ta dërgonin dhe për këtë arsye fillimisht e kanë dërguar në Gjykatën Penale të Shkallës së Parë Tiranë dhe pas kësaj në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për shkak të kësaj situatë ajo është dërguar me vonesë para gjykatës.

Përveç sa më lart, ajo është ankuar se punonjësit e policisë e kanë mbajtur atë për disa orë në bodrumin e gjykatës, veprim ky që i ka shkaktuar frikë, pasiguri dhe panik.

Në lidhje me sa më sipër i jemi drejtuar me shkresën nr. K2/I60-2 prot., datë 24.09.2020 Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Tiranë, Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë dhe për dijëni Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

DVP Tiranë me shkresën nr. 7166/1 prot., datë 05.10.2020 ndërmjet të tjerave na informoi se për të bërë shoqërimin e shtetasës M. M., me masë sigurie “Arrest në shtëpi”, për në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për arsye kohe dhe shpejtësie ka shkuar shërbimi i Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë, rreth orës 10:40 të datës 12.09.2020. Patrulla ka komunikuar me shtetasën M. M. duke i bërë prezent detyrimin që ajo kishte në lidhje me shoqërimin për në gjykatë, por ajo u ka kërkuar punonjësve të policisë urdhrin e nxjerrë nga gjykata, të cilin punonjësit e policisë për arsye kohe nuk e dispononin me vete. Për këtë arsye shtetësja M. M. nuk ka pranuar shoqërimin e saj.

Për situatën e krijuar është bërë me dije gjykata e cila ka kërkuar dërgimin e një punonjësi policie për të marrë urdhrin e shoqërimin. Me marrjen e urdhrin nr. 94, datë 11.09.2020, ai i është komunikuar shtetasës M. M. dhe pas kësaj ajo është shoqëruar për në gjykatë.

Strukturat e Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë nuk kanë pasur dijëni për urdhrin nr. 94, data 11.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sepse sekretaret e DVP Tiranë nuk e kishin adresuar këtë shkresë, pasi urdhri i gjykatës nr. 94, datë 11.09.2020 ishte protokolluar ditën e premte rreth orës 13:20 dhe dita e zbatimit të urdhrin të shoqërimin ishte ditë pushimi. Për këtë shkelje ndaj punonjësve të sekretarisë të këtij organi ka filluar hetimi disiplinor në bazë të Rregullores së Policisë së Shtetit nr. 750, datë 16.09.2015.

Për sa i përket pretendimeve të saj, që gjatë shoqërimin nuk ka qenë e pranishme një punonjëse policie femër, kjo ka ndodhur vetëm në itinerarin nga banesa e saj për në gjykatë, pasi Komisaritati i Policisë nr. 6 Tiranë nuk ka pasur të planizuar dhe planifikuar punonjëse të policisë femër patrullë lëvizëse për kontrollin e territorit. Kurse gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore dhe pas përfundimit të saj, në itinerarin nga gjykata në banesë, shoqërimi i shtetasës M. M. është bërë në praninë e punonjësës së policisë femër, punonjëse që ishte planizuar me përgjegjësinë funksionale, roje për sigurinë e objektin të komisarariatit.

Lidhur me ankesën se punonjësit e policisë që e kanë shoqëruar shtetasën M. M. nuk dinin se në cilën gjykatë do të dërgonin, u informuam se hyrja prapa Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është ngjitur me hyrjen e Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Tiranë, ku janë futur fillimisht shërbimet e policisë. Personeli i shërbimit i ka orientuar punonjësit e policisë se hyrja e shtetasve me masë sigurie “Arresti në shtëpi” bëhej nga hyrja përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së

Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Pas këtij sqarimi, menjëherë punonjësit e policisë kanë kaluar nga pjesa e përparme e godinës së kësaj gjykate.

Ndërsa në lidhje me shqetësimin e saj se ajo është mbajtur disa orë në bodrumin e gjykatës dhe se është frikësuar e ka qenë në gjendje paniku, u informuam se gjatë rivlerësimit të masës së sigurimit personal ajo nuk ka qëndruar për asnjë moment në bodrum dhe nuk është mbajtur nga punonjësit e policisë me orë të zgjatura, por sapo ka mbërritur është futur menjëherë në sallën e gjyqit.

Ndërkohë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 3757/3 prot., datë 14.10.2020 ndërmjet të tjerave na informoi se, ky rast është vlerësuar edhe nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, e cila në përfundim të verifikimit për mangësitë e konstatuara ka rekomanduar fillimin e hetimit disiplinor për personat përgjegjës në DVP Tiranë dhe në Komisariatin e Policisë nr. 6 Tiranë, rekomandim i cili është zbatuar nga drejtuesit e DVP Tiranë.

Pas shqyrtimit të ankesave të shtetases M. M. të cilat tashmë janë bërë publike në media dhe të përgjigjeve të dërguara në institucionin tonë nga DVP Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të cituara më sipër rezulton e provuar se pavarësisht arsyeve dhe rrethanave të krijuara në datën 12.09.2020, punonjësit e policisë në kohën kur kanë shkuar në banesën e shtetases M. M. nuk e kanë disponuar urdhrin nr. 94, datë 11.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shoqërimin e saj nga banesa për në gjykatë. Gjithashtu rezulton e provuar se në përbërjen e grupit të punonjësve të policisë të ngarkuar me detyrën e shoqërimit të kësaj shtetaseje nga banesa për në gjykatë nuk ka qenë një punonjëse e policisë femër, e të njëjtës gjini me të shoqëruarën.

Sjellim në vëmendje se gjatë veprimtarisë së përditshme për ruajtjen e rendit, sigurisë publike, si dhe për përmbushjen e përgjegjësiave policore e të detyrave të tjera, punonjësve të policisë u lind nevoja për të kryer shoqërime të shtetasve të ndryshëm në ambientet e komisariateve/stacioneve të policisë apo në institucione të tjera.

E drejta e punonjësve të Policisë së Shtetit për të bërë shoqërimin e shtetasve në mjediset e organeve të policisë, rastet dhe qëllimet e aplikimit të masës së shoqërimit, përgjegjësitë e punonjësve të policisë në rastet e shoqërimit, zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar, dokumentimi i shoqërimit në polici dhe rregullat teknike të

shoqërimit janë parashikuar në mënyrë shumë të qartë në nenet 6/25¹, 109² dhe 122/1³, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me urdhrin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në kreun V “Rastet dhe qëllimet e aplikimit të shoqërimit” të Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” parashikohet se:

“Akti/veprimi i shoqërimit të detyrueshëm si akt i shtrëngimit personal, mund të kryhet vetëm kur ekzistojnë kushtet e rastet e përcaktuara në ligj, si:

A. Për identifikimin e personit;

B. Si masë mbrojtëse;

C. Ekzekutimin e një urdhri apo detyrimi të njohur me ligj;

¹ Neni 6 “Përkufizime”

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

25. “Shoqërimi” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.

² Neni 109 “Shoqërimi në polici”

1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;

b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale;

ç) për të parandaluar kryerjen e një veprë penale;

d) kur është larguar pas kryerjes së një veprë penale;

dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;

e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent;

ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.

3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

4. Efektivi i policisë njofton menjëherë qendrën operative për gjenealitetet e personit të shoqëruar, kur ato njihen, orën e saktë të shoqërimit dhe shkaqet e tij. Të dhënat e komunikuar nga efektivi i policisë hidhen menjëherë në sistemin elektronik të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave. Mosrespektimi nga efektivi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

5. Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

6. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë eprorin e vet ose institucionin e interesuar për sqarimin e çështjes. Të dhënat e veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dokumentohen gjithashtu në regjistrat/librat që mbahen për këtë qëllim në ambientet e policisë ku është bërë shoqërimi i personit.

7. Për rastet e shoqërimit për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimin ose ekstradimin, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

8. Rregullat teknike të shoqërimit, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar në ambientet e policisë përcaktohen nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

³ Neni 122 “Masat mbrojtëse”

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit të sëmurë mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjitëse të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës.

D. Sqarimin e një rrethane.

Në rastin në shqyrtim, punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë kanë bërë shoqërimin e shtetases M. M. në bazë të gërmës “C” të Kreut “V” të Procedurës së cituar më sipër. Nga përmbajtja e kësaj dispozite kuptohet se, kur shoqërimi i një shtetasi bëhet në bazë dhe për zbatimin e një urdhri apo detyrimi të njohur me ligj, punonjësit e policisë domosdoshmërisht duhet të disponojnë aktin në fjalë dhe se atë duhet t’ja bëjnë të njohur personit që do të shoqërohet. Mosdisponimi i këtij akti nga punonjësit e policisë në momentin e parë kur kanë shkuar në banesën e shtetases M. M. për të bërë shoqërimin e saj për në gjykatë nuk është një qëndrim korrekt dhe në përputhje me Procedurën standarde të punës të cituar më lart. Kjo ka sjellë si pasojë dyshime, keqkuptime tek personi i shoqëruar, cenim të dinjitetit dhe të besimit publik të organit të policisë, si dhe vonesë në kryerjen e detyrës së ngarkuar për zbatimin e aktit (urdhrit) të shoqërimit.

Është rasti të theksojmë rëndësinë e ndjekjes së procedurave të miratuara me akte normative ligjore e nënligjore, pasi zbatimi i tyre me korrektësi ka si qëllim uljen dhe eliminimin e veprimeve potencialisht të padrejta të punonjësve dhe strukturave të Policisë së Shtetit gjatë veprimtarisë së përditshme për kryerjen e misionit ligjor të saj. Ndonëse nuk jemi para një rasti të tillë, por vlerësojmë të sjellim në vëmendje se mungesa e dokumentit të veprimit mbi bazën e një dokumenti shkresor është premisë për të zbatuar urdhra të paligjshëm, ndërkohë që Policia e Shtetit ka detyrimin ligjor të mos i zbatojë ato. Veprime të tilla mund të sjellim pasoja të rënda dhe cenime të të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve të ndryshëm.

Ndërsa mosprezenca e një punonjësi të policisë të gjinisë femër për shoqërimin e shtetases M. M. në itinerarin nga banesa e saj në gjykatë vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me Kreun VII, pika 5, gërma “h” të Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”. Në këtë dispozitë parashikohet se:

“Gjatë kryerjes së veprimeve me persona të shoqëruar të seksit femër, është e detyrueshme që të sigurohet prezenca e një punonjësi policie të seksit femër.”

Pra, nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton në mënyrë të qartë se, prezenca e një punonjësi të policisë të gjinisë femër gjatë kryerjes së veprimeve me persona të shoqëruar të gjinisë femër duhet të sigurohet në çdo rast dhe rrethanë.

Nga përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dërguar me shkresën nr. 3757/3 prot., datë 14.10.2020 rezulton se, ky rast është vlerësuar edhe nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, e cila në përfundim të verifikimit për mangësitë e konstatuara ka rekomanduar fillimin e hetimit disiplinor për personat përgjegjës në DVP Tiranë dhe në Komisariatin e Policisë nr. 6 Tiranë, rekomandim i cili është zbatuar nga drejtuesit e DVP Tiranë. Ndërsa nga përgjigjja e dërguar nga DVP Tiranë me shkresën nr. 7166/1 prot., datë 05.10.2020 rezulton se për këtë shkelje ka filluar hetimi disiplinor ndaj punonjësve të sekretarisë të këtij organi në bazë të Rregullores së Policisë së Shtetit nr. 750, datë 16.09.2015.

Nga përgjigjet e cituara më sipër konstatohet se hetimi disiplinor është filluar vetëm ndaj punonjësve të sekretarisë të DVP Tiranë për shkak të mos dërgimit në kohën e duhur në Komisarariatin e Policisë nr. 6 Tiranë të urdhrit nr. 94, datë 11.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shoqërimin e shtetases M. M. nga banesa për në gjykatë në datën 12.09.2020. Ndërsa për shkeljen e Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë

së Shtetit” lidhur me mos prezencën e një punonjëseje policie në përbërje të grupit të shoqërimit të shtetasës M. M. nuk është filluar hetimi disiplinor. Pra, nga DVP Tiranë nuk është zbatuar plotësisht rekomandimi i bërë nga Drejtoria e Standardeve Profesionale.

Ndërkohë konstatojmë se nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nuk është bërë ndonjë reagim lidhur me analizimin e kësaj situate, përgjithësimin e këtij rasti, që cenon imazhin e Policisë së Shtetit në publik, në strukturat vendore dhe mospërsëritjen e tij në të ardhmen.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi më të fortë nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve gjatë shoqërimit në ambientet/mjediset e komisariateve/stacioneve të policisë apo në institucione të tjera në përputhje me aktet normative në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme nga DVP Tiranë dhe Komisariati i Policisë nr. 6 Tiranë për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personave përgjegjës për mos planizimin me shërbim në përbërje të grupit të shoqërimit të shtetasës M. M. nga banesa për në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në datën 12.09.2020 të një punonjësi të policisë të gjinisë femër, në zbatim të detyrimit të parashikuar në Kreun VII/5/h të Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat vendore të Policisë së Shtetit me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi: S. Nushi